



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3237/ 2 prot

Datë 29.12.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4S” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr REF-88777-11-22-2023 me objekt **“Furnizim dhe sherbime me ushqim per menca”** me fond limit 8,373,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04-12-2023 nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik ‘4S’ SHPK nr NIPT L644254001K  
*Lagja “Xhevder Nepravishta”, Rruga “Qerim Arapi”,  
Pasuria nr 24/104-N4*
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.  
*Rruga “Dritan Hoxha”, Njësia Administrative nr. 11 Laprakë,  
Tiranë*

Në datën 28.12.2023 në formë shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 3237 e operatorit ekonomik “4S” SHPK për procedurën e “E hapur, e thjeshtuar” me nr REF-88777-11-22-2023 me objekt “Furnizim dhe sherbime me ushqim per menca” me fond limit 8,373,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04-12-2023 nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë..

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomike “4S” SHPK

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “4S” SHPK në ankesën nr. 3237 datë 28.12.2023 , pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

*Eshte oferte anomalisht e ulet, Autoriteti kontraktor i ka kerkuar operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 29.12.2023

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**